



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.10, datë 21/03/2005

**“MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.18,
DT.26/01/2001 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE
TË NJËSIVE BASHKIAKE TË TIRANËS”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32 (gërma ç), Ligjit Nr. 8654, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës, Ligjit Nr.8549, dt.11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr.9131, dt.08/09/2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.18, dt.26/01/2001 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.51, dt.03/11/2004 “Për delegimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake të qytetit të Tiranës”, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.18, dt.26/01/2001 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, miratohet struktura organizative e Njësive Bashkiake të Tiranës, sipas organigramës bashkëlidhur.
3. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.18, dt.26/01/2001 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”, shfuqizohet.
4. Pika 6 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.51, dt.03/11/2004 “Për delegimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake të qytetit të Tiranës”, shfuqizohet.
5. Efektet financiare të këtij Vendimi të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.
6. Ndarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Njësitë Bashkiake të Tiranës për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI